

Megi Metalla

Mban pozicionin e Drejtuesit të Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit që prej muajit mars 2022. Znj. Metalla është pjesë e stafit të Avokaturës së Shtetit që prej muajit korrik 2019 si Avokate Shteti pranë Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror. Ka një karrierë të gjatë në administratën publike si: Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, Bashkia Tiranë. Është diplomuar si jurist pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 2010 si dhe ka kryer Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Që nga viti 2016 mban titullin Avokat pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë.